

RELACION SHPJEGUES

“PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 61/2012 ‘PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKT-AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, është mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 155, të Kushtetutës dhe ka si qëllim të përcaktojë që:

- nga data 01 janar 2025, pulla fiskale si letër me vlerë dhe monopol shtetëror do të prodhohet dhe shpërndahet nga një person i autorizuar nga Këshilli i Ministrave.
- elementët e sigurisë dhe çmimi i pullës fiskale përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Ky projektligj vjen si rrjedhojë e përfundimit në datë 31 dhjetor 2024 të kontratës së koncesionit, të miratuar me ligjin nr. 10 381, datë 24.2.2011 “*Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “Sicpa Security Solutions”, SA e “Sicpa Security Solutions” Albania, sh.p.k për projektimin, financimin dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave*”, i ndryshuar, sipas së cilës prodhimi, shpërndarja e monitorimi i pullave fiskale të akcizës aktualisht kryhet nga shoqëria koncesionare.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2024.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT-AKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi nga Parlamenti i kontratës së koncesionit për pullat fiskale, me ligjin Nr.10 381, datë 24.2.2011 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave si autoritet kontraktues dhe shoqërive “Sicpa Security Solutions S.A.” e “Sicpa Security Solutions Albania sh.p.k.”, për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”, sipas së cilit prodhimi dhe shpërndarja e pullave fiskale kryhet nga shoqëria koncesionare, u shoqërua me ndryshimet përkatëse edhe në ligjin për akcizat, si ligj i fushës ku është përcaktuar detyrimi i vendosjes së pullave fiskale për disa produkte akcize.

Me ligjin nr. 17/2023 “Për miratimin e kontratës shtesë për ndryshimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si Autoritet Kontraktues, dhe shoqërive “Sicpa Security Solutions” SA e “Sicpa Security Solutions Albania” sh.p.k për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave, miratuar me ligjin nr. 10381, datë 24.2.2011”, afati i kësaj kontrate u zgjat për një periudhë një vjeçare, deri në datën 31 dhjetor 2024.

Në këto kushte, Ministria e Financave pasi bëri një analizë të akteve ligjore e nënligjore, ka vlerësuar se, ligji për akcizat në RSH, ka nevojë të ndryshohet në tre nene kryesore që lidhen me koncesionarin.

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” mban të pandryshuar përcaktimin (neni 40 i ligjit) se pullat fiskale janë letra me vlerë dhe monopol shtetëror. Përpara dhënies me koncesion, nga viti 2008 deri në vitin 2012, shtypja e pullave fiskale është kryer nga një shoqëri aksionare në pronësi të shtetit, e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Nga data 1 janar 2025, propozohet që prodhimi dhe shpërndarja e pullave fiskale të kryhet nga një person i autorizuar nga Këshilli i Ministrave.

Gjithashtu, për efekt të rëndësisë që kanë elementët e sigurisë së pullave fiskale propozohet që këta elementë të përcaktohen me VKM.

Sa i përket procedurës së porositjes së pullave fiskale, ajo mbetet e njëjtë, por pagesat e çmimeve të pullave fiskale dhe kostove të dërgesave do ti paguhet personit të autorizuar nga Këshilli i Ministrave.

Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në harmoni me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe mbështetet në nenet: 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me acquis Communautaire.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT

Projektligji përbëhet nga 4 nene.

Në **nenin 1**, përcaktohet se, pika 1 e nenit 40 “Statusi i pullave fiskale”, ndryshon me përmbajtjen si më poshtë:

“Pulla fiskale është dokument me vlerë dhe është monopol shtetëror. Këshilli i Ministrave përcakton personin e autorizuar për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave fiskale, si dhe elementët e sigurisë së tyre.”

Në **nenin 2**, përcaktohet se, në pikën 8, gërma d), të nenit 41 “Aplikimi i pullave fiskale” hiqet fjala “*me koncesionarin*”.

Në **nenin 3**, përcaktohet se, në nenin 42 “Pagesa dhe tërheqja e pullave fiskale” bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1, ndryshohet me përmbajtjen: “1. Çmimi për çdo pullë fiskale të prodhuar dhe të shpërndarë nga personi i autorizuar përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.”.
2. Pika 2 riformulohet me përmbajtjen: “2. Të gjithë prodhuesit dhe importuesit, të cilëve, sipas ligjit, u kërkohet të aplikojnë pullën fiskale i paguajnë personit të

Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”

autorizuar çmimin e pullave të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.”.

3. Në pikën 3, fjala “koncesionarin”, zëvendësohet me togëfjalëshin “personin e autorizuar për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave fiskale. ”.

Në nenin 4, përcaktohet se, ky akt botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë, me përjashtim të neneve 2 dhe 3, efektet e të cilave fillojnë nga 1 Janari 2025.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT DHE QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Ministria e Financës ka draftuar projektligjin. Ky projektligj do t’i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrin të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit dhe Ministrin të Shtetit dhe Kryenegociator.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.

Ky projektligj nuk shoqërohet me kosto për buxhetin e shtetit.

MINISTËR

Ervin Mete